



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Më: 10.03.2017

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 126.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 20 të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, nenit 12.1 (a),(b), të Rregullës nr. 14/2015 Mbi Financimin Subjekteve Politike dhe Sanksionet, merrë këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e gjobës

- I. Partisë Politike, "FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR" me akronim FDBK, i shqiptohet gjobë në shumën prej treqind e pesëdhjetë (350) euro, për dorëzim me vonesë të të dhënave të ndryshuara vjetore në afat prej nëntëmbëdhjetë (19) ditëve.
- II. KQZ-ja, i transferon të gjitha pagesat administrative në Buxhetin e Kosovës.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftojë Partinë Politike, "FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR - FDBK", për pikën I të këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Partia politike, "FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR - FDBK", gjobitet për arsye se nuk ka përmbushur në afat ligjor obligimet që dalin nga neni 11 të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, për dorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimin nr 98/2017 të datës 07.02.2017 i ka dhënë afat shtesë prej njëzet ditësh për dorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore, sipas nenit 6.1 (cc) . Partia Politike, "FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR - FDBK", ka dorëzuar të dhënat e ndryshuara vjetore me date 27.02.2017 me nr.protokolli 381/17

Valdete Daka

Kryetare e KQZ-së

